



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
*Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa*  
*Izborni Panel za Žalbe i Predstavke*

**Anr. 366/2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhammed Shala kryesues, Ymer Hoxha dhe Hasan Shala anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR), dega në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega në Prishtinë, për shkak të vendosjes së banerit mbi rrugë publike, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 01.11.2013, mori këtë:

**VENDIM**

**Miratohet** si e bazuar ankesa e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR ), dega në Prishtinë, kështu që subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) i shqiptohet dënim i më gjobë në vlerë prej 1450 (njëmijë e katërqind e pesëdhjetë ) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi.

**Arsyetim**

Me datën 29.10.2013, PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga AKR, në të cilën theksohet se me datën 29.10.2013, në Lagjen Tophane në Prishtinë anëtarë të subjektit politik AAK, kanë vendosur postera (pano) mbi rrugë publike, ku me këtë veprim sipas parashtreesit të ankesës janë shkelje të , neni 3 pika 3.2 të Rregullores Zgjedhore.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur një fotografi si dëshmi.

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi subjektin politik AAK, me datën 30.10.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 31.10.2013, brenda afatit të caktuar PZAP-i, pranoi përgjigjen në ankesë në të cilën theksohet se më të pranuar njoftimin për dukjen e posterit të kandidatit të AAK-së mbi rrugën publike, struktura menajuese e fushatës, konkretisht shtabi zgjedhor për komunën e Prishtinës, ka bërë largimin e këtij posteri, dhe ka ofruar disa fotografi në të cilën dëshmohet veprimi i largimit të posterit të vendosur mbi rrugët publike të Prishtinës, nga persona të paidentifikuar.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

**Ankesa është e bazuar**

Nga fotografit të cilat gjenden në shkresat e lendes identifikohet qart se baneri i kandidatit të AAK-së për kryetar të Komunës në Prishtinë është i vendosur mbi rrugë publike siç

pretendohet në ankesën me te cilin veprim subjekti politik AAK ka rënë në kundërshtim me dispozitit ligjore te neni 33 pika b) të LZP-së.

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njofuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

PZAP-i, mori parasysh të gjitha rrethanat si rënduese ashtu edhe rrethanat lehtësuese. Si rrethanë rënduese mori se ka marr pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara dhe se konsiderohet se është e njofuar me procesin zgjedhor dhe faktin se banerin e kandidatit për kryetar komune në Prishtinë kanë qenë të vendosur në vendin e palejuar për vendosjen e banerit. Ndërsa si rrethanë lehtësuese PZAP-i, mori se AAK, pas marrjes së kërkesës për përgjigjes në ankesë nga PZAP-i, brenda afatit të caktuar, ka ndërmarr veprime të dukshme për evitim e shkeljes, duke i larguar menjëherë fotografit nga vendi ku pretendohet se ka ndodhur shkelja e supozuar.

Andaj PZAP-i duke marr parasysh të gjitha arsyet e lartçekura se nga ana e AAK-së është shkelur nen 4 paragrafi 1 pika "b" të Rregullës Zgjedhore 11/2013 të KQZ-së dhe nenin 33 pika b) të LZP-së, pasi që banerin e kandidatit për kryetar të komunës të AAK-së është i vendosur mbi rrugët publike, si dhe duke pasur parasysh veprimet e menjëherësme të subjektit politik AAK-së, për evitim e shkeljes së supozuar si dhe përpjekjet për të parandaluar veprimet e ndaluara në bazë të provave të cilat i ka ofruar të bashkangjitura përgjigjes në ankesë të cilat veprime kanë ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptua, prandaj në kuptim te nenit 120 paragrafi 1 pika c), si dhe nenit 118.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

#### Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresë

Anr. 366/2013 më datën 01.11.2013.



Kryesuesi i Panelit  
Muharrem Shala

**Këshillë Juridike:** PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat përi-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5,000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.